

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist pranë OSSH** / Departamenti i Matjes dhe Mbështetjes së Tregut / Drejtoria e Menaxhimit të Matjes dhe Kërkesave të Përdoruesve të Rrjetit / Sektori i Menaxhimit të Proçeseve dhe Fuqisë Punëtore.

SPECIALIST

Specialisti i Menaxhimit të Fuqisë Punëtore është monitoruesi i një tërësi proçesesh të përqëndruara për të ndihmuar në maksimizimin e performancës së Rajoneve, në mënyrë që të arrihen qëllimet e paracaktuara të kompanisë.

Detyrat dhe Përgjegjësitë :

- Shërben si monitorues në kohë reale të proçeseve.
- Sigurohet që të realizohen planet e punës së marra sipas autorizimeve përkatëse.
- Kontrollon veprimtarinë duke siguruar që të gjitha veprimet janë paraqitur konform rregullave proçeduriale dhe konform rregullave të dokumentacioneve.
- Kontrollon dhe verifikon dokumentacionet e ngarkuara në modulin workforce.
- Monitoron që aktiviteti realizohet konform rregullave, proçedurave dhe udhëzimeve të punës.
- Për të rritur performancën dhe efikasitetin e të gjithë aktiviteteve, siguron:
 - a) Fuqia Punëtore të jetë produktive;
 - b) Përmirësimin e proçeseve dhe rritjen e efikasitetit;
 - c) Monitorim të realizimit të planeve të punës;
 - d) Analizën e të gjithë çështjeve të mbyllura;
 - e) Raportimin e të gjithë problematikave të hasura gjatë kontrollit të proçeseve;
- Raporton periodikisht tek eprori i tij mbi mbarëvajtjen e të gjithë proçeseve.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të ketë Diplomë Universitare.
- Njohuri shumë të mira për sistemet kompjuterike.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi për të bashkëvepruar me kolegët dhe drejtuesit.
- Të kuptojë ligjet dhe të ketë njohuri për proceset e punës.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.